

VENDIM
Nr.740, datë 1.11.2006

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË QENDRËS KOMBËTARE SHKENCORE TË
HIDROKARBUREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të neneve 138 e 145 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve.
2. Punonjësit që dalin të papunë nga mbyllja e veprimtarisë së kësaj Qendre, të trajtohen nga fondet e papërdorura, në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, miratuar për vitin 2006, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Asetet, baza materiale dhe arkivi i Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve të administrohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nëpërmjet një strukture dhe procedure të miratuar me urdhër të Ministrit.
4. Vendimi nr.410, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve dhe për miratimin e statusit të saj”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha